



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 22/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi- Kryetar, z. Blerim Dina -Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA” SH.P.K -Prishtinë, kundër propozimit (Njoftimit mbi Vendimit të AK-së) për dhënien Kontratës Ku është Rekomanduar për Kontratë OE: "ONIX-S" SH.P.K - Gjilanë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatorëve kushtuar heroit kombëtar Kadri Zeka Gjilan” me nr te prok: 651-20-5049-4-2-3 iniciuar nga AK/ – “KK-GJILAN, më datën: 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “ATELEA E SKULPTURËS MONOMENTALE AGON QOSA” SH.P.K -Prishtinë, kundër njoftimit për dhënien Kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i skulpturës së shtatorëve kushtuar heroit kombëtar Kadri Zeka Gjilan” me nr te prok: 651-20-5049-4-2-3 iniciuar nga AK/ – “KK-GJILAN.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: “Ndërtimi i skulpturës së shtatorëve kushtuar heroit kombëtar Kadri Zeka Gjilan” me nr te prok: 651-20-5049-4-2-3 iniciuar nga AK/ – “KK-GJILAN, dhe Lënda të kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: “ATELEA E SKULPTURËS MONUMENTALE AGON QOSA” SH.P.K -Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik: “ATELEA E SKULPTURËS MONUMENTALE AGON QOSA” SH.P.K -Prishtinë, që konform nenit 31 pika 4 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditës të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “ATELEA E SKULPTURËS MONUMENTALE AGON QOSA” SH.P.K - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 08.01.2021 me nr. 22/21, kundër propozimit (Njoftimit mbi Vendimit të AK-së) për dhënien Kontratës lidhur me aktivitetin te prokurimit me titull:: “instalimi i kamerave në disa Institucione Edukativo Arsimore”, me numër të prokurimit: 613-20-6340-5-2-1, të iniciuar nga AK/. “KK-LIPJAN”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin:1, 7, 27, 51, 52, 59, 75 si dhe nenin 80, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.01.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.


Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 19.01.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1



Duke marre parasysh kriteret e tenderit, tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te specifikuara nga AK ne Njoftimin për Konkursin e Projektimit dhe ne Dosje te Tenderit, është parapare qe modeli i shtatores te plotësoj shumë parametra artistik si me poshtë: Shprehja figurative dhe zgjidhja kompozicionale artistike e shtatores duhet të jete ne harmoni dhe te respektojë dimensionet dhe funksionin e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronz; Shtatorja si konceptim dhe si interpretim

artistik duhet të jetë shprehje figurative në të cilën reflektohen qartë tiparet e Heroit kombit Kadri Zeka; Figura, simbol i luftës për liri të popullit shqiptar duhet të jetë e vendosur me pamje ballore nga rruga Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupore; Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs. Boceti i paraqitur nga konkurruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 50 deri në 70 cm i lartë, pa bazamentin; realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj) të prezantojë emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar. Konkurruesit - Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim; Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëjë ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes së kompozicionit me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit. Shtatorja nëpërmjet realizimit cilësor duhet të pasurojë vlerën e sheshit dhe të evidentojë elementet që shprehin simbolikën e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka;

Disa nga fotot e Heroit kombëtar Kadri Zeka



OE ankues ka ofruar sqarime profesionale dhe dëshmi rreth dy moduleve-proporcioneve te trupit te njeriut: Standardi i njeriut shtatlartë 7 x madhësia e kokës + $\frac{1}{2}$ shputa e këmbës Standardi i njeriut shtatshkurtër 5 x madhësia e kokës + $\frac{1}{2}$ shputa e këmbës.



Eksperti shqyrtues pretendimet ankimore të OE ankues i konsideron si te bazuara, dhe konstaton se AK nuk e ka bere përzgjedhjen e duhur te modelit me shifrën 6666 pasi qe ky model është punuar sipas proporcioneve te njeriut shtatshkurtër 5 x madhësia e kokës + ½ shputa e këmbës, e qe nuk korrespondon me Heroin kombëtar Kadri Zeka, i cili nuk ka qene me trup te shkurtër por me gjatësi rreth 175 cm.

Boceti i rekomanduar për kontrate me shifrat 6666 nuk i plotëson parametrat e kërkuara figurative, konceptuale, heroike, artistike dhe kompozicionale, te kërkuara ne NJKP dhe ne DT. Është i pa kuptueshëm vlerësimi i komisionit te AK, kur merret parasysh dallimi rrënjësore ne mes te dy modeleve 6666 – i rekomanduar dhe 8888 – ankues. Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar me 99.95% modelin e rekomanduar me shifrën 6666, ndërsa me 52.98% modelin e OE ankues me shifrën 8888, qe ne fakt është dashtë te jete se paku e kundërta Dallimi ne mes modelit 6666 – i rekomanduar dhe 8888 – ankues, është “si nata me ditën”



Bazuar ne Qëllimin e Konkursit të Projektimit, si dhe duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, si Ekspert Shqyrtues pa dashur te kontestoj profesionalizmin e anëtareve te jurisë, por me qëllimin me fisnik te vlerësimit sa me te drejtë, dhe duke marre parasysh se është hera e dytë e shqyrtimit te lëndës se njëjtë ne OSHP, nga këndvështrimi im profesional nuk pajtohem me përzgjedhjen e bocetit me shifrën 6666, krahasuar me bocetin e OE ankues me shifrën 8888. Boceti i rekomanduar nuk paraqet: zgjidhje kompozicionale artistike te shtatores- (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: konceptim dhe interpretim artistik dhe shprehje figurative në të cilën reflektohen qartë tiparet e Heroit kombëtar Kadri Zeka - (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: Figurën si simbol i luftës për liri të popullit shqiptar- (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit...- (siç është kërkuar).

Boceti i rekomanduar nuk paraqet: nuk prezanton emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar - (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: realizimin cilësor qe të pasurojë vlerën e sheshit dhe të evidentojë elementet që shprehin simbolikën e figurës së Heroit kombëtar Kadri

Zeka - (siç është kërkuar). Boceti 6666 i përzgjedhur nga AK me shume ngjason me ndonjë personalitet tjetër me moshe te shtyrë, kur dihet se heroi Kadri Zeka është vrare ne moshën 29 vjeçare. Boceti6666 i përzgjedhur nga AK nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne detyrën projektuese, nuk i ka tiparet faciale te Heroit Kombëtar Kadri Zeka, nuk e ka qëndrimin krenar dhe burrëror, qe i takon një personaliteti te tillë, por asocon ne një person nënshtrues, frikacak dhe te shtangur. Boceti6666 i përzgjedhur nga AK nuk asocon me Heroit Kombëtar Kadri Zeka, nuk paraqet një model reprezentativ te figurës se heroit, nuk shprehë vendosmërinë intelektuale dhe fisnikërinë e një figure heroike te historisë krahasuar me modelin8888.

Ndërsa boceti nr. 8888 i ofruar nga OE ankues, është model shumë me i qëlluar, me përmbajtjesorë, me reprezentativ, me mendje hapur, me vizionar për qëllimet e tija atdhetare, reflekton imazhin e intelektualit dhe veprimtarit te çështjes kombëtarë siç i ka hije Heroit Kombëtar Kadri Zeka. Boceti 8888 i OE ankues e pasuron vlerën e sheshit shumë me tepër se modeli i OE te rekomanduar 6666. Boceti 8888 i OE ankues e prezanton emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka dhe do ta bëjë krenar te gjithë familjen, shokët dhe qytetarët qe e shohin si monument. Boceti 8888 i OE ankues integrohet fuqishëm dhe korrespondon vizuelisht me hapësirën e sheshit, kjo shtatore do ta rrisë vlerën e sheshit, ku gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori i këtij boceti, siç është lejuar ne detyrën projektuese te këtij Konkursi të Projektimit: nëse është e nevojshme, mund të bëjë ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin.

Boceti 8888 i OE ankues, pa asnjë dyshim është model me i mirë, është model me meritë për shpërblim me kontratë, model qe reflekton trimërinë, fisnikërinë, nivelin arsimor, ndërgjegjësimin dhe vendosmërinë intelektuale e patriotike, model qe do ti rezistoj kohës dhe do të jetë monument i pëlqyer edhe nga gjeneratat e reja qe do vinë. Pretendimi i OE ankues se gjate procesit te rivlerësimit te kërkohet qe te marrin pjese edhe oj q mediat dhe familjaret e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, duhet te kihet parasysh për seriozitetin e lendes dhe objektivitetin për vlerësim meritë. AK gjate procesit te rivlerësimit, nuk e ka marre parasysh Vendimin e OSHP-se nr. 902/20 i datës 24.11.2020, ku pjesërisht i është aprovuar ankesa te njëjtit OE ankues, ku edhe pse PSH dhe eksperti shqyrtues nuk e ka trajtuar aspektin artistik, por nder te tjera është theksuar pretendimi i OE ankues se oferta e tij është me e mire dhe kjo vërehet edhe nga personat laik.

Ky aktivitet i prokurimit për te dytën here po shqyrtohet nga OSHP, ku subjekt i trajtimit është pikërisht aspekti artistik pasi qe AK nuk e ka vlerësuar drejtë këtë aktivitet te prokurimit, pavarësisht kualifikimit profesional te anëtareve te komisionit rivlerësues. Duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, me përgjegjësi profesionale mund te konstatoj se modeli 8888 i OE ankues,

pa asnjë dyshim është model me meritë për shpërblyer me kontratë, me i arritur në këtë konkurs projektimi, si për nga aspekti artistik, monumental, vizionar, reprezentativ, realizim me kreativ-artistik që korrespondon me kohën dhe hapësirën, që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj). Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe AK në bazë të kompetencave të tyre ta bejë rivlerësimin në mënyrë objektive konform LPP-së dhe RRUOPP-së, kërkesave të specifikuara në NJKP dhe DT, të obligohet AK që të marrë për bazë konstatimet profesionale të cekura në këtë ekspertizë dhe vendimin e Panelit Shqyrtues.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht të anulohet propozimi për dhënie të kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit të kthehet lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 20.01.2021 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 20.01.2021, përmes emailit ka njoftuar OSHP-në Të nderuar, Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Gjiçanit konfirmon pranimin e Raportit të ekspertit shqyrtues, me nr. 22-21 /20 të datës 20.01.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “ Ndërtimi i skulpturës së shtatores kushtuar heroit kombëtar Kadri Zeka Gjiçan ”, me nr. të prokurimit 651-20-5049-4-2-3. AK – Kuvendi Komunal i Gjiçanit, nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues – teknik Duke pasur parasysh se ofertat janë vlerësuar nga një komision profesional dhe me përvoja pune në këtë lëmi. Andaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues – OSHP, që në një afat sa më të afërt kohor të caktohet seanca kryesore dhe të njoftohet AK – me Vendimin e Panelit Shqyrtues.

Operatori Ekonomik: datën 20.01.2021 përmes emailit ka njoftuar OSHP-në, Të nderuar në konfirmojmë pranimin e shkresës , gjithashtu në si OE ankues pajtohemi në plotësi me mendimin e ekspertit shpresojmë që mendimin e ekspertit ta marrin parasysh paneli shqyrtues dhe autoriteti kontraktues Komuna e Gjiçanit ju faleminderit.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.02.2021, nëpërmjet platformës elektronike ZOOM, në ora 13:30, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-së ankues, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit

të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së ankuese i cili deklaroi : ne si OE pajrohemi plotësisht me mendimin e ekspertit dhe i kemi edhe ne ankes shkeljet dhe kundërshtimet që i kanë bërë Komuna e Gjiçanit dmth AK ata nuk e kanë respektuar dhe kanë bërë kundërshtim me ligjin e prokurimit publik duke shkelur nenin 1, 7, 27, 51, 52 , 59, 75 dhe 80 ne kërkojmë që lenda të kthehet në rivlerësim dhe gjithashtu mendimi i ekspertit është në rregull jemi pajtë plotësisht me mendimin e ekspertit dhe shpresojmë që edhe bordi OSHP të pranojë këtë mendimin e ekspertit dhe lenda të kthehet në rivlerësim

Në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të AK-së, i cili deklaroi: pa dashtë me hyj në procedura juridike të cilat nuk i njoh shumë komisioni i cili ka qenë në vlerësimin e par është një komision shumë profesional që përbëhet prej tre profesorëve universitar që të dy kandidatët që ma vonë e kemi kuptuar kush jon realisht kanë mbaruar fakultetin të ne dhe në baxhet konkursit i cili ka qenë i shpallur kandidati i cili ka dalë figura apo ceta fitues ka qenë edhe është vlersu me poenë më shumë se dy buceta të tjera , nëse e mendoni në asketin profesional që në buxhetin mbas konkursit që ju e kemi shpallur si komunë dhe ankuesit duhet ta keni të qartë se nuk ka mjeshtër në botë skulptor i cili një kokë që është 4 5 centimetra lyet më tej për ngjyë në karakter shumë . Ekspert e profesionit të skulpturës e them me shumë kompetencë janë të thirrur ta vlersojnë figurën qëndrimin e saj edhe të shohim anën kompozicionale të figurës por jo karakterin sepse si duket ka qenë shumë ose jo po komuna është dashtë me kërku edhe në portret që bahet zakonisht në konkursin për masë natyrore për më pa karakterin e personazhit në këtë rast të heroit Kadri Zeka me sa unë kam kuptuar që është bërë edhe në komisionin tjetër edhe komisioni tjetër ka vlersu përafërsisht si komisioni i parë prandaj unë si antar i komisionit bashkë edhe me profesorin tjetër z. Behlulin nuk jemi absolut njerëz që nuk kemi provuar se jemi profesor që një kohë të gjatë edhe të dy prej nesh janë autor që veprat e tyre janë nëpër institucione shumë të rëndësishme e jo vetëm në Kosovë por edhe jashtë Kosovës prandaj është shumë e pa bazë që në ankues prej vendit të tret me më pak poenë të bëjë shumë bujë kaq të madhe përndryshe nësi komisioni kemi pa edhe vërejtje edhe i kemi evidentuar vërejtjet të cilat i kemi pa fillimisht kemi mujt me pa se nëse në parim kemi pas neje buxhet të rregullt nëse kërkesa ka qenë që buceta të jetë prej 50 deri 70 centimetra buceta e zotëruar edhe shumë më e madhe . Aspekti tjetër profesional është që na kemi pa prej ankuesit disa foto që ka marrë koka krejtësisht varet buceta që shfaqet fotografet prej cilit kënd fotografohet unë më shumë përgjigjisi më marrë që çdo figurë që të fotografon varet prej këndit që të fotografon për më preciz madhësinë pranë edhe kjo është e pa qëndrueshme ankes

është ne aspektin profesional nese flasim ankuesi apsolutisht as aji fare nuk përngjan me portretin e heroit Kadri Zeka une fillimisht e thash ne rast se kerkojm bucet ngjajshmeri ajo është e pamundur qe ne ni bucet 70 centimetra me kerku karakterin prandaj lypet ana kompozionale qëndrimi .

Tjetra qe është me rendësi merrni figurat shifeni dora e djathtë qysh është e nxanun absolutisht te pjesa ma e madhe te 99% e figurave nuk nxinte qysh ju ka nxan ne zakonisht ne bazë te përvojës dhe historisë te skulptures qe nëse personazheve jon te ngarkime me diqka perveq armatimit qoft libra qoft sako dora e djath është gjithmonë e lire bile bile edhe ne ato situatat kur martohet nusja shkon ne anën e majtë kështu qe është pasurde gabim fillestar ky me analizu sene te tilla une mendoj qe dy bucetat me shumë përgjegjësi e them edhe si komision kanë qen ma te mira se buçeta e ankuesit ne kete rast e Agon Qoses.

Nese neve na mashtrojnë ngjyrat ju qe besoni ne historin e skulpturave dhe besoni po e tham qe kaniher mka perngja ne ato lodrat kineze qe shiten neper tregje dhe aj patinim nuk esh teme se pari as profesional as epik as moral ne fund te fundit

Ne fjalën përfundimtare ekspertit z. Marmullaku i cili deklaroj : jom mundu qe ta beje nje përshkrim te duhur dhe objektiv te fakteve dhe parametrav te cilat i ka parapa AK ne dosjen e tenderit te cilat kan qen bukur te detajizume si kërkesa si parametra te cilat se si duket nje bucet nje model nga ana e kompanive ofertuese por siq shihet edhe ne ekspertiz do te thot ato parametra nuk jan zbatu gjat rivlerësimit nga ana e komisioneve te AK dhe une prap qendroj prapa ekspertieas te ciline kam dhan dhe e degjova me kujdes edhe perfaqsesin e AK antarin e komisionit profesionistin me te then te drejten pak um befasoj ajo se dallimi ne mes ketyre dy buçetave është mjaft i kjart buçeta te cilen AK e ka përzgjedh si fitues as per se afermi nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne dosje te tenderit dhe as per se afermi nuk mund te krahasohet me buletin modelin e prezantuar te ofruar nga OE ankues dhe qendroj mas asaj qe kom shkru ne ekspertiz se modeli i heroit kombëtar Kadri Zeka duhet te pasqyroj nje krenari nje fisnikëri intelektualizmin te cilin e ka pas moshen te cilen është vra dhe jo modelin te cilin AK e ka përzgjedh i cili me te vertet asocon me teper me nje person te nënshtruar nje person frikacak dhe te shtangur dhe i cili model është i paraqitur me nje person bukur te shtyme e jo ne moshen 29 vjeqre kur është vra hero i kombëtar Kadri Zeka gjithashtu ne ankesen e OE ankues jan cek edhe parametrat e shtatoreve doimoenzione me kode ku dimensionin i njeriut shtat lar shtat here edhe madhësia e kokës dhe 1 e 2 shputa e këmbës qe është aplikua nga OE ankues dhe qe i korrespondon madhsis reale te heroit Kombetar ndersa boceti i OE te rekomanduar është me trup shtat shkurtër realisht është me dimensione shtat herë madhësia e kokës dhe një e dyta e shputës e qe ne fakt e jep një imazh jo real te figurës se heroit Kadri Zeka kto janë te deshmume ne ekspertizë edhe me syrin laik shihet dallimi ne mes te ketyre dy boceteve ani pse profesori mundohet ta arsyetoj se është vetëm bocet dhe nuk ka pasur nevojë qe te detajozohet mirëpo edhe qe nuk ehte e detajizume qëndrimi i bocelit te rekomanduar pasqyron imazhin e një hero i qe duhet ta ketë te cilin AK edhe vet ne kriteret e dosjes se

tenderit i ka kërkuar është kerku qe te ketë shprehje figurative , zgjidhje kompozicionale artistike koncept , interpretim artistik . figurativ simbol i luftës për liri te popullit shqiptar etj etj ketu me te drejt e kom konstatua se nuk i plotëson boceli i rekomanduar nga ana e AK andaj me te drejt ju rekomandoj juve si panel i nderum shqyrtues qe ankesa e OE ankues te merret si e bazuar dhe AK ti përfill kto mendime profesionale dhe vullnetmira per zgjidhjen e modelit te duhur ma te qellum për këtë monument .


E kom cek edhe ne ekspertizë qe nuk dua ta kontestoj as profesionalizimin as nivelin profesional dhe gradat e komisionit te vlerësimit por vlerësimi mendoj qe nuk është bërë ne mënyrën e duhur ne mënyrën e drejt edhe do te ishte shumë e drejt e dobishme objektive qe AK te vlesoj objektivisht dhe t aperzgjedh modelin e OE ankues përndryshe edhe vet fakti qe oferta e OE ankues te rekomanduar eshte ne vleren sa është e parashikime ne dosjen e këtij tenderit te jep me kuptu diçka . përndryshe modeli i rekomanduar nuk i shkon as sheshit as nuk e reprezenton heroin e as nuk e rrit vlerën e sheshit ndërsa te kundërtën e bene modeli i OE ankues qe ne çdo aspekt besoj është ma i drejt dhe ma objektiv

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:


Paneli Shqyrtues Konform Ekspertit Shqyrtues sqaron se Duke marre parasysh kriteret e tenderit, tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te specifikuara nga AK ne Njoftimin për Konkursin e Projektimit dhe ne Dosje te Tenderit, është parapare qe modeli i shtatores te plotësoj shumë parametra artistik si me poshtë:Shprehja figurative dhe zgjidhja kompozicionale artistike e shtatores duhet të jete ne harmoni dhe te respektojë dimensionet dhe funksionin e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronz; Shtatorja si konceptim dhe si interpretim artistik duhet të jetë shprehje figurative në të cilën reflektohen qartë tiparet e Heroit kombit Kadri Zeka; Figura, simbol i luftës për liri të popullit shqiptar duhet të jetë e vendosur me pamje ballore nga rruga Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupe; Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs. Boceti i paraqitur nga konkurruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 50 deri ne 70 cm i lartë, pa bazamentin; realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj) të prezantojë emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar. Konkurruesit - Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim; Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes së kompozicionit me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit. Shtatorja nëpërmjet realizimit cilësor duhet të

pasurojë vlerën e sheshit dhe të evidentojë elementet që shprehin simbolikën e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka;

Disa nga fotot e Heroit kombëtar Kadri Zeka



Paneli Shqyrtues Konform Ekspertit Shqyrtues sqaron se OE ankues ka ofruar sqarime profesionale dhe dëshmi rreth dy moduleve-proporcioneve te trupit te njeriut: Standardi i njeriut shtatlartë 7 x madhësia e kokës + ½ shputa e këmbës Standardi i njeriut shtatshkurtër 5 x madhësia e kokës + ½ shputa e këmbës.



Paneli Shqyrtues Konform Ekspertit Shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore të OE ankues i konsideron si te bazuara, dhe konstaton se AK nuk e ka bere përzgjedhjen e duhur te modelit me shifrën 6666 pasi qe ky model është punuar sipas proporcioneve te njeriut shtatshkurtër 5 x madhësia e kokës + ½ shputa e këmbës, e

qe nuk korrespondon me Heroin kombëtar Kadri Zeka, i cili nuk ka qene me trup te shkurtër por me gjatësi rreth 175 cm. Boceti i rekomanduar për kontrate me shifrat 6666 nuk i plotëson parametrat e kërkuara figurative, konceptuale, heroike, artistike dhe kompozicionale, te kërkuara ne NJKP dhe ne DT. Është i pa kuptueshëm vlerësimi i komisionit te AK, kur merret parasysh dallimi rrënjësore ne mes te dy modeleve 6666 – i rekomanduar dhe 8888 – ankues. Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar me 99.95% modelin e rekomanduar me shifrën 6666, ndërsa me 52.98% modelin e OE ankues me shifrën 8888, qe ne fakt është dashtë te jete se paku e kundërta Dallimi ne mes modelit 6666 – i rekomanduar dhe 8888 – ankues, është “si nata me ditën”.



Bazuar ne Qëllimin e Konkursit të Projektimit, si dhe duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, si Ekspert Shqyrtues pa dashur te kontestoj profesionalizmin e anëtareve te jurisë, por me qëllimin me fisnik te vlerësimit sa me te drejtë, dhe duke marre parasysh se është hera e dytë e shqyrtimit te lëndës se njëjtë ne OSHP, nga këndvështrimi im profesional nuk pajtohem me përzgjedhjen e bocetit me shifrën 6666, krahasuar me bocetin e OE ankues me shifrën 8888. Boceti i rekomanduar nuk

paraqet:zgjidhje kompozicionale artistike te shtatores- (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: konceptim dhe interpretim artistik dhe shprehje figurative në të cilën reflektohen qartë tiparet e Heroit kombëtar Kadri Zeka - (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet:Figurën si simbol i luftës për liri të popullit shqiptar- (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: realizim kreativ-artistik që korrespondon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit...- (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet: nuk prezanton emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar - (siç është kërkuar). Boceti i rekomanduar nuk paraqet:realizimin cilësor që të pasurojë vlerën e sheshit dhe të evidentojë elementet që shprehin simbolikën e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka - (siç është kërkuar). Boceti 6666 i përzgjedhur nga AK me shume ngjason me ndonjë personalitet tjetër me moshe te shtyrë, kur dihet se hero i Kadri Zeka është vrare ne moshën 29 vjeçare. Boceti6666 i përzgjedhur nga AK nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne detyrën projektuese, nuk i ka tiparet faciale te Heroit Kombëtar Kadri Zeka, nuk e ka qëndrimin krenar dhe burrëror, që i takon një personaliteti te tillë, por asocon ne një person nënshtrues, frikacak dhe te shtangur. Boceti6666 i përzgjedhur nga AK nuk asocon me Heroit Kombëtar Kadri Zeka, nuk paraqet një model reprezentativ te figurës se heroit, nuk shprehë vendosmërinë intelektuale dhe fisnikërinë e një figure heroike te historisë krahasuar me modelin8888. Ndërsa boceti nr. 8888 i ofruar nga OE ankues, është model shumë me i qëlluar, me përmbajtjesorë, me reprezentativ, me mendje hapur, me vizionar për qëllimet e tija atdhetare, reflekton imazhin e intelektualit dhe veprimtarit te çështjes kombëtarë siç i ka hije Heroit Kombëtar Kadri Zeka. Boceti 8888 i OE ankues e pasuron vlerën e sheshit shumë me tepër se modeli i OE te rekomanduar 6666. Boceti 8888 i OE ankues e prezanton emocionalisht fizionominë dhe karakterin e figurës së Heroit kombëtar Kadri Zeka dhe do ta bej krenar te gjithë familjen, shokët dhe qytetarët që e shohin si monument. Boceti 8888 i OE ankues integrohet fuqishëm dhe korrespondon vizuelisht me hapësirën e sheshit, kjo shtatore do ta rrisë vlerën e sheshit, ku gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori i këtij boceti, siç është lejuar ne detyrën projektuese te këtij Konkursi të Projektimit: nëse është e nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin.

Boceti 8888 i OE ankues, pa asnjë dyshim është model me i mirë, është model me meritë për shpërblim me kontratë, model që reflekton trimërinë, fisnikërinë, nivelin arsimor, ndërgjegjësimin dhe vendosmërinë intelektuale e patriotike, model që do të rezistoj kohës dhe do të jetë monument i pëlqyer edhe nga gjeneratat e reja që do vijnë. Pretendimi i OE ankues se gjatë procesit të rivlerësimit të kërkohej që të marrin pjesë edhe ojqi mediat dhe familjarët e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, duhet të kthehet parasysh për seriozitetin e lëndës dhe objektivitetin për vlerësim meritë. AK gjatë procesit të rivlerësimit, nuk e ka marrë parasysh Vendimin e OSHP-se nr. 902/20 i datës 24.11.2020, ku pjesërisht i është aprovuar ankesa te njëjtë OE ankues, ku edhe pse PSH dhe eksperti shqyrtues nuk e ka trajtuar aspektin artistik, por ndër të tjera është theksuar pretendimi

i OE ankues se oferta e tij është me e mire dhe kjo vërehet edhe nga personat laik.


Paneli Shqyrtues sqaron se Ky aktivitet i prokurimit për te dytën here po shqyrtohet nga OSHP, ku subjekti i trajtimit është pikërisht aspekti artistik pasi që AK nuk e ka vlerësuar drejtë këtë aktivitet të prokurimit, pavarësisht kualifikimit profesional të anëtareve të komisionit rivlerësues. Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Kadri Zeka, me përgjegjësi profesionale mund të konstatoj se modeli 8888 i OE ankues, pa asnjë dyshim është model me meritë për shpërblim me kontratë, me i arritur në këtë konkurs projektimi, si për nga aspekti artistik, monumental, vizionar, reprezentativ, realizim me kreativ-artistik që korospondon me kohën dhe hapësirën, që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siç janë portreti, duart, këmbët, veshja etj). Bazuar në çka u tha më lartë, Eksperti Shqyrtues konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe AK në bazë të kompetencave të tyre ta bëjë rivlerësimin në mënyrë objektive konform LPP-së dhe RRUOPP-së, kërkesave të specifikuar në NJKP dhe DT, të obligohet AK që të marrë për bazë konstatimet profesionale të cekura në këtë ekspertizë dhe vendimin e Panelit Shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nubi Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – “Kuvendit Komunal Gjilanë” ,

1x1 OE – “ATELEA E SKULPTURËS MONUMENTALE AGON QOSA” SH.P.K -Prishtinë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.